

Njoftim

Njoftohen të gjithë qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës, se nga sot, 16.11.2015, fillon të aplikohet në gjendje reale Projekti “Aplikimi nga Distanca për shërbime të Gjendjes Civile”.

Tani e tutje të gjithë qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës, mund të aplikojnë nëpërmes uebfaqes zyrtare të komunës së Fushë-Kosovës për t’u pajisur me dokumente të Gjendjes Civile: Ekstrakt i Lindjes, Certifikatë e Lindjes, Certifikatë e Martesës, Certifikatë e Vendbanimit dhe Certifikatë e Shtetësisë, etj.

Pas aplikimit për t’u pajisur me ndonjë dokument, ky shërbim do t’i ofrohet qytetarit të komunës së Fushë-Kosovës nëpërmes postës.

Komuna e Fushë-Kosovës do të vazhdojë së aplikuari edhe projekte të tilla të ngjashme të digjitalizimit të shërbimeve administrative në ofrimin e shërbimeve sa më të shpejta, më efikase dhe më transparente për të gjithë qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës.

Linku për aplikim është ky:

<http://kk.rks-gov.net/fushekosove/AplikimiOnlineFK.aspx> .